



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution
Autoriteti Kompetent

AD.nr.18/2024

Datë: 03.01.2025

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga avokati F.K., i autorizuar i të akuzuarit A.P., kundër N.S., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 03.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore kundër N.S., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pasi që duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 11.12.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të të akuzuarit A.P., avokati F.K., ka pranuar ankesën disiplinore kundër prokurores N.S., e cila ka qenë në përfaqësim pranë gjykatës kompetente të lëndës PP/I.nr..., ku në këtë ankesë disiplinore, parashtruesi i saj pretendon se prokurorja ka bërë rikualifikimin e veprës penale pa pasur autorizim ligjor, pretendon se prokurorja përmes parashtrësave të ndryshme të dorëzuara në gjykatë ka bërë fabrikim dhe manipulim dhe ka paraqitur një pasqyrim të pavërtetë e që të njëjtat parashtrës paraqesin edhe tejkalim të kompetencave dhe detyrave të prokurores në fjalë, ka ndërhyrë në punët e prokurorit tjetër duke e urdhëruar kolegen e saj nga Departamenti i Krimeve të Rënda që të pushojë hetimet ndaj të pandehurit D.L., me pretendimet se prokurorja është ndikuar nga pala e dëmtuar, me pretendimet se prokurorja N.S. ka theksuar se vazhdimisht udhëzohet nga Kryeprokurorët, e sipas të njëjtit kjo nënkupton se ka qenë joprofesionale, neglizhente dhe nuk e respekton ligjin, me pretendimet se prokurorja e çështjes ka fabrikuar me prova në procedurë, ashtu që ka marrë prova nga një lëndë tjetër, prokuror tjetër dhe departament tjetër dhe të njëjtat prova i ka përdorë për t'i ndërhyrë në hetim prokurorit tjetër, duke rënduar kundërligjshëm pozitën e të akuzuarit në procedurë. Në fund të ankesës disiplinore, parashtruesi i saj ka kërkuar nga ne si Autoritet

Kompetent që të aprovojme ankesën disiplinore si të bazuar dhe ndaj prokurores në fjalë të merren masa disiplinore të parapara me ligj.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Prokurores N.S.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Me datë 11.12.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore nën numrin AD.nr.18/2024.

Me datë 12.12.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimit e ankesës disiplinore dhe regjistrimin e saj.

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 11.12.2024, kemi pranuar ankesën disiplinore nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së akuzuar në lëndën PP/I.nr..., av.F.K., përmes së cilës ankesë i njëjti pretendon se prokurorja N.S., e cila ka qenë në përfaqësim të lëndës PP/I.nr..., me ndërmarrje të disa veprimeve ka rënë ndesh me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në ankesën disiplinore të dorëzuar pranë Autoritetit Kompetent, pala ankuese pretendon se prokurorja ka bërë rikualifikimin e veprës penale pa pasur autorizim ligjor, pretendon se prokurorja përmes parashtresave të ndryshme të dorëzuara në gjykatë ka bërë fabrikim dhe manipulim dhe ka paraqitur një pasqyrim të pavërtetë e që të njëjtat parashtresa paraqesin edhe tejkalim të kompetenca dhe detyrave të prokurores në fjalë, ka ndërhyrë në punët e prokurorit tjetër duke e urdhëruar kolegen e saj nga Departamenti i Krimeve të Rënda që të pushojë hetimet ndaj të pandehurit D.L., me pretendimet se prokurorja është ndikuar nga pala e dëmtuar, me pretendimet se prokurorja N.S. ka theksuar se vazhdimisht udhëzohet nga Kryeprokurorët, e sipas të njëjtit kjo nënkupton se ka qenë joprofesionale, neglizhente dhe nuk e respekton ligjin, me pretendimet se prokurorja e çështjes ka fabrikuar me prova në procedurë, ashtu që ka marrë prova nga një lëndë tjetër, prokuror tjetër dhe departament tjetër dhe të njëjtat prova i ka përdorë për t'i ndërhyrë në hetim prokurorit tjetër, duke rënduar kundërligjshëm pozitën e të akuzuarit në procedurë. Në fund të ankesës disiplinore, parashtuesi i saj ka kërkuar nga ne si Autoritet Kompetent të aprovojme ankesën disiplinore si të bazuar dhe ndaj prokurore në fjalë të merren masa disiplinore të parapara me ligj.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurores N.S. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/I.nr...

Deklarimet e Prokurores N.S. në raportin e dërguar më datë 18.12.2024

Prokurorja N.S., në raportin e saj të dërguar përmes postës elektronike në zyrën e Kryeprokurorit më datë 18.12.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *“Lidhur me rastin në çështjen penale kundër të pandehurit A.P., Prokuroria Themelore në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, me date 05.08.2023 ka filluar hetimet kundër të pandehurit A.P., në drejtim të veprës penale Vrasje e Rëndë nga neni 173 par .1 nën par 1.5 të KPRK-së, veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par 2 të KPRK-së, si dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të Përgjithshëm nga neni 356 të KPRK-së. Hetimet kanë filluar edhe kundër të pandehurit D.N. (L.), në drejtim të veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë nga neni 173 par 1 nën par 1.5 të KPRK-së, veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par 2 të KPRK-së, si dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të Përgjithshëm nga neni 356 të KPRK-së. Kundër të pandehurve A.P , D.N. dhe H.G., secili veç e veç në drejtim të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, hetimet kanë filluar edhe kundër të pandehurve H.G. dhe G.Z. , në drejtim të veprës penale Pjesëmarrja në rrahje nga neni 187 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti Krimeve të Rënda ,me Aktvendim ka pushuar hetimet kundër të pandehurve H.G. dhe G.Z., ndërsa ka pezulluar Hetimet , kundër të pandehurit D.L., në drejtim të veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë nga neni 173 par 1 nën par 1.5 të KPRK-së, veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par 2 të KPRK-së, si dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të Përgjithshëm nga neni 356 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda, me datë 21.06.2024 , ka ngritur Aktakuzën kundër të pandehurit A.P. , në drejtim të veprës penale Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fort Mendore nga neni 174 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në Pronës, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së. Me të njëjtën lëndë me numër PP.nr..., për ta përfaqësuar në gjykatë unë jam ngarkuar me të njëjtën dhe në seancat e radhës të mbajtura në Gjykatë me dt.19.09.2024 , është mbajtur fjala hyrëse dhe propozimi për tu dëgjuar dëshmitarët. Në seancat e mbajtur në Gjykatë me dt.01.10.2024 është dëgjuar si dëshmitare bashkëshortja e të ndjerit K.R., me date 01.10.2024 më seancën e radhës janë dëgjuar dëshmitarët G.Z. i cili në detaje ka treguar rastin e ndodhur në ditën kritike. Me date 29.10.2024 është dëgjuar si dëshmitar I.G., i cili në deklaratën e tij ka sqaruar se si ka ndodhur rasti në fjalë duke potencuar në fund të deklaratës së tij se në ditën kritike i njëjti kur ka hyrë në mes të A.P. dhe D.L. njërën dorë ja ka qitë A. mbi krah dhe tjetrën dorë e ka kapur për dorë D.L. tu u mundua me qetësua situatën, dhe arsyeya që ja ka mbajtur dorën është se D. ja ka parë armen të cilën e mbante në dorë, posa kam filluar që ta lëvizë dorën D. në ato qaste duke pasur parasysh se po qe se do të ja lëshonte dorën D. mundej me gjuajt edhe ai, dëshmitari I. ka shtuar se unë nuk ja kam lëshuar dorën D. deri sa janë ndalur të shtënat e armëve dhe është larguar A. nga lokali. Në seancën e radhës të mbajtur në Gjykatë me datë 30.10.2024, është dëgjuar Eksperti i Forenzikës A.G. , i cili deklaratën e tij duke qëndruar në tërësi si në konkludimin e dhënë në ekspertizën e dt.07.05.2024, që sipas ekspertit sa i përket shëndetit mendor të pandehurit A.P., kjo ekspertizë është bazuar në intervistimin klinik psikiatrik në mënyrë ambulatorie, shqyrtimit të shkresave të lëndës, dokumentacionit mjekësor, ekzaminimeve radiologjike dhe imazhirike dhe në bazë të tyre grupi i ekspertëve ka konstatuar se te i pandehuri A.P., nuk konstatohen elemente psikotike dhe se nuk kem të bëjmë me elemente sëmundjes apo çrregullim mendor, tek i njëjti nuk konstatohet deficit intelektual apo prapambetje mendore, sipas ekspertit në momentin e fillimit të zënkës te A.P. para shkrepeve të armëve për shkak të goditjes në kokë në mënyrë të papritur i njëjti ka përjetuar frikë të intensitetit të lartë që ka të*

bëjë me cenimin dhe integritetin e tij ku sipas ekspertit i pandehuri për shkak të gjendjes së Rëndë mendore ka ndikuar në rënien e aftësive mendore për ti kontrolluar veprimet e veta dhe humbjes së logjikës së pasojave të këtyre veprimeve në këtë gjendje e ka kryer veprën, në pyetjet e bëra eksperti ka konstatuar se të gjitha testet e kryera tek i pandehuri A.P. (si ato neourologjike dhe ekzaminimet radiologjike si TKT dhe EEG ka rezultuar të jenë negative, te i pandehuri nuk ka asnjë veçori patologjike. Në seancat e mbajtura në Gjykatë me vonë janë dëgjuar edhe dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria e shtetit, siç jeni në njohuri edhe ju çdo veprim i bërë në këtë çështje penalo juridike e kam bërë në koordinim me juve. Ndërsa në pyetjen e Avokatit F.K. se çfarë lidhje kam me të ndjerin K.R., nëse ju kujtohet me momentin që e kam marr lëndën kam ardhur në zyrën tuaj dhe ju kam njoftuar paraprakisht se tani i ndjeri dhe familja e tij jeton në fshatin ..., ku edhe unë i kam dajhtë e mi dhe jetojnë në të njëjtin fshat dhe njihen mirë njeri me tjetrin, si dhe ju kam njoftuar me faktin se A.P. jeton në afërsi të banesës ku edhe unë e kam vendbanimin tim, duke ju paralajmëruar që mos ta përfaqësoj këtë lëndë në gjykatë për arsye se palët në këtë rast mund ta humbin besimin në paanshmërinë time. Andaj në këtë drejtim, unë si Prokurore që më parë kam qenë e ngarkuar për ta përfaqësuar në gjykatë lëndën me numër të rastit PP.I.Nr... , kundër të pandehurit A.P., në drejtim të veprës penale Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fort Mendore nga neni 174 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në Pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, ju sigurojë që rastin konkret nuk kam bërë asnjë shkelje ligjore sa i përket punës sime dhe Kodit të Etikës dhe atë neni 6, par.2 pika 2.10 për përgjegjësi disiplinore të gjyqtareve dhe prokurorëve.”

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se në veprimet e ndërmarra nga prokurorja N.S., prokurore e cila ka qenë në përfaqësim të lëndës PP/I.nr..., nuk janë shprehur shkelje disiplinore të sanksionuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent ka ardhur deri te ky përfundim pas analizimit të pretendimeve nga ankesa disiplinore e palës ankuese, pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga ana e prokurores N.S., kundër së cilës është paraqitur kjo ankesë disiplinore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës penale PP/I.nr... dhe rrjedhës së procedurës në këtë çështje penale, e nga të gjitha këto shqyrtime dhe analizime kemi ardhur te ky përfundim, se prokurorja në fjalë nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Pretendimet se prokurorja ka bërë rikualifikimin e veprës penale pa pasur autorizim ligjor nuk qëndrojnë, kjo për faktin se me asnjë akt të kësaj prokurorie nuk është bërë rikualifikimi i veprës penale në një vepër e cila do e rëndonte pozitën e të akuzuarit në procedurë. Prokuroria Themelore në Prishtinë mbetet në përfaqësimin e lëndës sipas aktakuzës për të akuzuarin A.P. për veprën penale Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 174 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPR të Kosovës, andaj në rastin konkret nuk është bërë asnjë rikualifikim dhe mbi këto fakte vërtetohet edhe se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë.

Pretendimet se prokurorja N.S. më datë 15.10.2024 ka dorëzuar fillimisht një parashtrësë me kërkesë për shtyrje të seancës së dt. 22.10.2024, e pastaj në po të njëjtën ditë e ka dërguar një

parashtresë të përmirësuar, e që sipas palës ankuese këto parashtresa janë fabrikim dhe nuk kanë bazë në prova, konsiderojmë se parashtresat e prokurores N.S. i janë drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht gjyqtarit të vetëm gjykues, e që këto parashtresa kanë pasur si qëllim kërkesën për anulim të seancës së dt.22.10.2024, si të tilla janë shqyrtuar dhe karshi tyre është vendosur nga gjyqtari i çështjes, andaj lidhur me parashtesat-kërkesat në fjalë palët në procedurë kanë pasur mundësinë e kundërshtimit të këtyre parashtresave - kërkesave në gjykatë.

Pretendimet se prokurorja N.S. ka ndërhyrë në punët e prokurorit tjetër duke e urdhëruar prokuroren e Departamentit të Krimeve të Rënda që të pushojë hetimet ndaj D.L., as një pretendim i tillë nuk qëndron, kjo për faktin se ndaj të pandehurit D.L. nuk janë pushuar hetimet, faktikisht ndaj të njëjtit janë pezulluar hetimet me Aktvendimin PP/I.nr... të dt.21.06.2025.

Pretendimet se prokurorja ka fabrikuar prova, ka marrë prova nga një lëndë tjetër, prokuror tjetër dhe departament tjetër dhe të njëjtat prova i ka përdorur për të ndërhyrë në hetim prokurorit tjetër duke i rënduar kundërligjshëm pozitën të akuzuarit A.P., as ky pretendim nuk qëndron, kjo për faktin se asnjë provë nuk është fabrikuar nga ana e prokurores, ndërkaq e ritheksojmë edhe njëherë se me asnjë veprim të prokurores nuk është rënduar pozita e të akuzuarit A.P., mbi të njëjtin ende rëndon akuza për kryerjen e veprës penale Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 174 i KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pretendimet se prokurorja N.S. është udhëzuar nga Kryeprokurorët, e sipas palës ankuese kjo tregon se e njëjta ka qenë joprofesionale, neglizhente dhe nuk e ka respektuar ligjin, as një pretendim i tillë nuk qëndron. Ligji për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.08/L-167) ka përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësitë e kryeprokurorëve, ku në pikën 1.8 të nenit 21 është përcaktuar se *“Kryeprokurori mund t’u jap udhëzime me shkrim prokurorëve të një prokurorie që udhëheq, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit”*, ndërkaq në nenin 6, paragrafi 2, pika 2.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), një ndër shkeljet e detyrave të prokurorit sipas këtij ligji, përfshijnë edhe veprimet në qoftë se prokurori i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë në rastet kur prokurori nuk vepron në përputhje me vendimet apo udhëzimet e ligjshme të kryeprokurorit, andaj fakti se prokurorja N.S. ka vepruar duke ndjekur udhëzimet e Kryeprokurorit nuk konsiderohet shkelje disiplinore, e njëjta po të mos vepronte karshi këtyre udhëzimeve, do të konsiderohej se kishte për të kryer shkelje disiplinore.

Në ankesën disiplinore, pala ankuese po ashtu ka cekur një varg pyetjesh të cilat sipas tij janë relevante për t’iu parashtruar prokurores N.S. për të konstatuar shkeljet e saj, e që një ndër pyetjet është se çfarë raportesh familjare ka e njëjta me palën e dëmtuar, duhet theksuar se prokurorja N.S. me të marrë lëndën në përfaqësim Kryeprokurorit ia ka bërë të ditur faktin se i ndjeri K.R. dhe familja e tij jetojnë në fshatin ..., ku në të njëjtin fshat prokurorja në fjalë i ka dajhtë si dhe na ka njoftuar me faktin se A.P. jeton në afërsi të banesës ku prokurorja në fjalë e ka vendbanimin, por që këto dy rrethana nuk paraqesin bazë ligjore për të përjashtuar prokuroren nga trajtimi respektivisht përfaqësimi i kësaj lënde penale, konform nenit 43 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se pretendimet e deklaruara në Ankesën disiplinore nuk paraqesin shkelje disiplinore, respektivisht ankesa disiplinore është e pabazuar, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar që veprimet e prokurores N.S. paraqesin shkelje

disiplinore në bazë të nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT KRYEPROKURORI



Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës